



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-28990/20  
Kaçanik, 24. 12. 2020

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e XI-të (Njëmbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2020 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 24 Dhjetor 2020. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 26 anëtarë, në ndërkohë arriti edhe anëtarja, Hafize Sallahi, kështu që konstatohet së pjesëmarrës të kësaj mbledhje ishin 27 anëtarë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtoret e drejtive komunale; Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku, Festim Neziraj, Fatmir Loku, Diana Reka dhe Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Bejtulla Dalloshi, Arbnora Kuka dhe Fatlume Guri-Selimi.

Nga OJQ (KDI), mbledhjen e monitoroj, Kijani Sallahu.

Nga strukturat vendore, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër të gjithë anëtarët. Prezentë në mbledhje për momentin janë 26 anëtarë, kuorumi ekziston, znj. Hafize Sallahu me ka njofuar se vjen në ndërkohë, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e XI-të (Njëmbëdhjetë) të Rregullt për vitin 2020, data 24 Dhjetor, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Rregullorja për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës;
3. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit të KK 01Nr.104/02-12813/2018 të datës 27.04.2020 –për formimin e Komitetit për Shërbime Publike;
4. Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, parcela kadastrale Nr. 00494-15, arë e klasës së 4, në emër të Amer Shaqir Shurdhani, për zgjerimin dhe ndërtimin e rrugës “Ismail Raka” në Kaçanik;

5. Rekomandimi i komisionit vlerësues për përgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (40 vjet), parcelat kadastrale me numrat: 402-0 dhe 403-0, në ZK Kaçanik i Vjetër, P.SH KK Kaçanik;
6. Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2021;
7. Raporti i punës i Shtabit Komunal për parandalimin e Covid -19;
8. Raport i përbushjes së Planit të integritetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019; dhe
9. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuara gjatë vitit 2020, shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Kaçanikut.

Ju njoftojmë së, Propozim Vendimi për ndarjen e Parcelës kadastrale Nr. 00143-1, në ZK Doganaj, P.SH. Kuvendi i Komunës Kaçanik, e cila ishte propozuar si pikë për shqyrtim në këtë mbledhje sipas ftesës për mbledhje, nuk është proceduar për KK nga KPF, për shkak së lënda është në procedurë të komisionit vlerësues. Rendin e propozuar të punës me e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### Aprovoj

**Redin e punës në përbërje prej 9 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

**1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;**

Vërejtje në Procesverbal paraqiti, Ekrem Raka, në f. 6, të pjesa e diskutimit, në një mjeshtë që ka probleme me shtëpinë e kulturës, hiqet pasuesi “shtëpinë” vazhdon teksti tjetër ashtu siç është shënuar.

Me këtë vërejtje, Procesverbali i mbledhjes se kaluar të Kuvendit të Komunës u aprovua me votën Abstenim të Nazife Krasniqi, për shkak së nuk ka qenë pjesë procesit. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### Aprovoj

**Procesverbalin e mbledhjes së X (Dhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës të datës 23.11.2020/ Lënda: 01Nr. 060/01-28990/20.**

Procesverbali do të publikohet në faqen zyrtare të komunës, i korrigjuar.

#### Pyetje dhe Kërkesa

**z. Ekrem Kyçyku**, Nuk jam i kënaqur me përgjigjen e z. Ukshin Qallaku, se ma merr mendja së e ka ditur për ku e kam fjalën për pyetjen të cilën e kam ngritur. Është një ndërtësë që është duke u bërë të shkolla fillore, dhe ajo ndërtësë ka filluar me u prishur.

2. E kam vizituar Shtegu që është bërë nga OJQ “Gjethi”, në Kërbliq, dhe ky projekt i këtij shtegu është në kundërshtim me rregullat e federatës së bjeshkatarëve alpiniste të Kosovës si dhe komisionit për shënjimin e shtigjeve të Republikës së Kosovës. Unë kam biseduar me kryetarin e komisionit për shënjimin e shtigjeve, dhe ata nuk kanë qenë për këtë shteg. Sipas tyre, së pari bëhet incizimi të gjypes x, pastaj, të merret numri i shtegut në Prishtinë dhe të vazhdohen punimet. Ky shteg është shumë i lehtë, mirëpo me shënjimi është kategorizuar i

vështirësisë së madhe. Janë bërë gabime, ka munguar bashkëpunimi me ne edhe me federatën, dhe konsideroj që ky shteg duhet të ribëhet, dhe kërkoj nga drejtoria, mos t'i shpenzoj mjetet në këtë projekt. Pjesa tjetër që është bërë rreth tavolinave në bjeshkatari është e mirë.

**z. Adnan Reka,** Kjo është mbledhja e 11 e rregullt e Kuvendit për këtë vit, apo jo? A do të thotë kjo se Kuvendi ka dështuar të mbajë 12 mbledhje të rregullta brenda këtij viti, për çfarë jemi të obliguar sipas Statutit te Komunës dhe Rregullores së Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Me LVL, Kuvendi i Komunës është i obliguar t'i mbaj brenda 1 viti 10 mbledhje të rregullta. Sivjet KK ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe 1 të jashtëzakonshme me pagesë, me çka është përbushur Plani i punës së KK. Unë jam munduar prej se kam ardhur me mbajtur maksimumin e mbledhjeve, për shkak të çështjeve që duhet trajtohen edhe për shkak të kompensimit. Edhe mbledhja e jashtëzakonshme ka qenë me pagesë, kështu që e kemi përmbyllur planin e punës së KK për vitin 2020.

**z. Shemsedin Luzha,** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, Unë kam me i ngritur do çështje, se po ndihem të anashkaluar në disa projekte. Fshati nga vijë unë f.. Begracë është i anashkaluar për çështje të kanalizimit, fushë futbolli nuk ka nga viti 2003. Ne të gjithë e dimë që Begracë është fshati me i madhi në komunën e Kaçanikut, ndërkaq që 17 vjet është pa fushë futbolli. Ndriçimi publik, rruga nga "Fusha e Pajtimit" e deri të pjesa që lidhet me Vitinë e ka një emër, dhe kemi qenë shumë të kënaqur me emërtimin e kësaj rruge, por është ndarë me ndriçim publik dhe me meremetim të rrugës. Shkolla është ndërtuar në vitin 2003, ndërkaq shkolla po riparohet, tani i ndërrohen dyert, e që nuk ka pasur nevojë, sepse mund të mos jenë kualitet ato dyer që i vendosen. Përgjigjet kërkoj t'i marrë tani nga Kryetari i Komunës. Unë jam përfaqësues i fshatit dhe kam ardhur me votën e qytetarëve të komunës këtu. Nëse ne nuk i marrim përgjigjet këtu, unë nuk e di pse jam këtu.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kërkoj që pyetjet dhe kérkesat të janë konkrete, ndërkaq për tema të caktuara, mundesh me kérkuar me u futur në rend pune me diskutuar si pikë e veçantë. Ne e kemi krijuar një rregull, me u parashtruar pyetjet dhe kérkesat, ndërkaq përgjigjet me i marrë në formë të shkruar në mbledhjen vijuese. Se a janë të gatshëm tani për tani me u përgjigjur ekzekutivi në pyetjet e juaja, unë nuk e di.

**z. Selim Reka,** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, shfrytëzoj rastin t'iu uroj festat e fund vitit;

1. Shprehi shqetësime për rrugën, "Avdurrahim Shehu" e cila rrugë në një pjesë të saj është shtypur një gyp dhe uji del në sipërfaqe të asfaltit.

2. Të rruga "Ismail Raka" i merret tokë pronarit, 253m<sup>2</sup> ndërkaq rruga përsëri ngelë e ngushtë për shkak të një ure që është dashur me u bërë të shtëpia e kulturës, e që ka pasur hapësirë dhe prona ka qenë e komunës. Kërkoj që kjo të rregullohet, ashtu që të realizohet projekti ashtu si duhet.

**z. Agim Mani,** Faleminderit kryesues, Përshëndetje për të gjithë;

Pyetje për DSHPE; Lidhur me objektin banesor "Idriz Seferi", Suvatimi i këtij objekti banesor e pashë së është bërë vetëm në pjesën ballore, jo edhe anët anësore. Nuk e di nëse është harruar çështja e suvatimit të pjesëve anësore.

**z. Bekim Koxha,** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, Unë i kam dy shqetësime të objekti i banimit social, kërkoj sqarime të nevojshme;

1. Për ndërtimin e objektit të banimit social, në vitin 2017 janë ndarë 343,974 euro, në vitin 2018 janë ndarë 34.000 euro për punë shtesë që ka pasur me u përfunduar projekti, por nuk janë kryer punët. Në vitin 2019 janë ndarë 78.515 euro, përsëri punët nuk janë kryer. Ku është arsyja që projekti nuk është realizuar? Tre herë ka pasur tender për këtë projekt, ndërkaq projekti nuk është realizuar ende. Kërkoi sqarim prej kryetarit dhe drejtorit të drejtorisë pse ka ngelur realizimi i këtij projekti ?

2. Rruga “ Avdurrahim Shehu” në vitin 2019 janë proceduar mjete, 120.000 euro, edhe në vitin 2020, 200.000 euro, dhe përsëri në vitin 2020, 11.000 euro mjete shtesë. Ku është arsyja, pse janë proceduar mjete shtesë dhe çka ka me u rregulluar me këto mjete pasi që u përfundua asfalti ?

**z. Lirije Luta,** Faleminderit kryesues, përvendetje për të gjithë; Unë desha me dhënë një informacion lidhur me Modulin 3 dhe 2 të trajnimeve, organizuar nga DEMOS, online përmes platformës Zom, Në këtë trajnim ka qenë i ftuar Kryesuesi i KK, anëtarët e KK, drejtori i DSHP, koordinatori i përformancës, zyrtari për barazi gjinore. Shqetësimi i DEMOS ka qenë së nga të gjithë të ftuarit e komunës tonë, kanë marrë pjesë, koordinatori i përformancës, zyrtari për barazi gjinore dhe nga KK kam marrë pjesë unë. znj. Fatime- përfaqësuese e DEMOS, kërkoi nga anëtarët e KK që nëse ka probleme me emale, emailet e tyre të cilat i përdorin t'i dërgoni të zyra për informim.

**z. Ekrem Raka,** Faleminderit kryesues, E para, Shemsedin Luzha ka të drejtë plotësish në bazë të LVL dhe Rregullores për punë të KK me iu bërë pyetje Kryetarit të Komunës, drejtorëve të drejtorive komunale dhe të me marrë përgjigjen drejtpërdrejtë tani. Unë në mbledhjen e kaluar e ngrita një pyetje Kryetarit të Komunës për çështjen stolisjes së qytetit, ndërkaq nuk mora përgjigje. Nuk është mirë të injorohem si kuvend në mos marrjen e përgjigjeve në pyetjet të cilat i adresojmë. Kërkoi nga Kryetari i Komunës të deklarohet për këtë injorim të KK për mos dhënien të përgjigjeve. Kuvendi i Komunës është organ më i lartë i komunës, ku kryetari e jep betimin para kuvendit, e jo kuvendit para kryetarit. Unë kam, kërkuar në një mbledhje që pozicionit, Pyetje dhe Kërkesa t'i shtohet edhe pasuesi “dhe Deklarimet jashtë rendit të ditës”, çështje kjo që po aplikohet edhe në Kuvendin e Kosovës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kuvendi i Kosovës nuk e kanë pozicionin ‘Pjetje dhe Kërkesa’, por Deklarimet jashtë rendit të ditës, ndërkaq të ne është formulimi” Pyetje dhe Kërkesa. Sipas Rregullores së punës së KK, është e drejtë dhe detyrë e anëtarit të KK të ngritë pyetje dhe kërkesa të pozicioni, Pyetje dhe Kërkesa. Ky pozicion është tejkaluar në çdo mbledhje, sepse janë bërë edhe komentime, ndërkaq komentimin nuk e jep rregullorja. Anëtarë i KK sipas LVL dhe Rregullores për punë të KK, ka drejtë të ngritë tema të caktuara me i debatuar në KK por jo si kërkesa. Kërkesat e pyetjet duhet të janë konkrete, të drejtuara ndaj kujt, ndërkaq çështja me u futur një pikë në rend pune, anëtarë i KK ka të drejtë me dhënë shpjegime pse është e nevojshme me u trajtuar ajo temë e veçantë. Shembull konkret është çështja e informatës së znj. Lirije Luta, ajo çështje nuk ka të bëjë me KK, është e drejtë e secilit anëtar të KK se a merr pjesë në mbledhje apo jo. Çështja me u përgjigjur kryetarit tani për tani, mund të mos i ketë të gjitha të dhënat, kështu që nëse është fjala për ndonjë projekt, atëherë e përgatitë për mbledhjen vijuese përgjigjen me të gjitha të dhënat.

**z. Bekim Koxha,** Kërkesa po bëjmë, por përgjigje nuk po marrim në kërkesat që po i ngritim.

**z. Shemsedin Luzha,** Unë kam bërë kérkesë, ndërkaq përgjigja nuk më është dhënë në formën e duhur nga drejtori i drejtorisë përkatëse. Kjo është një pa përgjegjësi dhe jo seriozitet e drejtorit.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kérkesa të tjera nuk ka, atëherë vazhdojmë me pikat tjera të rendit të punës;

**2. Propozim Rregullorja për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ne e kemi pasur një rregullore të këtij lloj, megjithatë kjo rregullore është me unike me specifika të veçanta për komunën. Për draft rregulloren janë zhvilluar proceduar e debatit publik me qytetarë, drejtori është prezent në mbledhje, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**zpj. Arlinda Rakoci-Raka,** Përvetësime për të gjithë, të draft rregullorja nuk e vërejtje se ka diçka për fëmijët me nevoja të veçanta, e që mendoj së duhet të jetë prioritet. Propozoj që këtij draft rregullores t'i shtohet edhe një nen, ashtu që ‘Për fëmijët me nevoja të veçanta, të kenë një ndihmë financiare të paktën për asistentët e këtyre fëmijëve’.

**zpj. Lirije Luta,** Unë kam qenë në Debatin publik të organizuar për këtë rregullore, shumica që kanë marrë pjesë i kanë dhënë rekomandimet e tyre. Pasi që rregullorja është unike për të gjitha komunat e Kosovës, jam për dhe uroj që rregullorja të jetë e zbatueshme.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Tani doli një propozim, unë nuk e di a rregullohet kjo çështje me ndonjë akt të veçantë, sidqoftë rregullorja mund të ndryshohet dhe plotësohet në të ardhmen. Atëherë Draftin e rregullores e shtroj në votim për aprovim pa propozimin që doli. Rezultati i votimit ishte; Për aprovimin e Rregullores votuan të gjithë anëtarët e KK me përashtim të Shemsedin Luzha i cili Abstenoj. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës vendosi të,

#### APROVOJ

**Rregulloren për përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijës /Lënda: 01Nr. 04-610/01-30862/20.**

**3. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit të KK 01Nr. 104/02-12813/2018 të datës 27.04.2020 –për formimin e Komitetit për Shërbime Publike;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Tani propozimi për një anëtar nga OJQ është në rregull sa i përket aspektit procedural, sepse propozimi është nënshkruar nga një anëtar tjeter i OJQ. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka,** Edhe në mbledhjen e kaluar kemi qenë kundër, sepse rokadat e anëtarëve nga KKSB ne këtë Komitet janë të paarsyeshme. Dhe tjetra, sepse është plotësisht në sh përputhje me Statutin e Komunës. Ju jeni mbështetur ne nenin 12 te Ligjit për VL, po ta shihni këtë nen mund ta kuptioni fare lehtë së ky nen bazohet kryesisht në Statutin e Komunës, i cili thotë qartë se Komitetit për Shërbime Publike është Komitet Konsultativ, prandaj kemi te bëjmë me shkelje ligjore. Ndërsa te gjithë abuzimin mundoheni ta arsyeton përmes një UA

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për , Kundër ishin 7 anëtarët nga LVV, Abstenoj Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

## VENDIM

**Për ndryshim plotësimin e vendimit të KK 01Nr. 104/02-12813/2018 të datës 27.04.2020 – për formimin e Komitetit për Shërbime Publike; ashtu që ish anëtarja e këtij komisioni, Afërdita Horuni (Shehi), zëvendësohet me Kijani Sallahi nga OJQ/ Shoqëria Civile /Lënda: 01Nr. 104/02-29811/20.**

**4.** Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, parcela kadastrale Nr. 00494-15, arë e klasës së 4, në emër të Amer Shaqir Shurdhani, për zgjerimin dhe ndërtimin e rrugës “Ismail Raka” në Kaçanik;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Materialin e keni marrë, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku**, Kjo pronë tani është asfalt, procedura nuk është në rregull, sepse shpronësimi i pronës në fjalë është dashur të bëhet me herët, e pastaj të bëhet asfaltimi i rrugës. Çka bëhet tani nëse KK nuk voton shpronësimin e pronës në fjalë ?

**Kryesuesi i Kuvendit**, Kemi pasur edhe raste të tjera të hershme që nuk janë bërë shpronësimet e pronave, ndërkaq janë realizuar projektet.

**z. Besim Vishi**, Kush e përcakton vlerën e kësaj parcele ?

**Kryesuesi i Kuvendit**, Agjencioni kadastral e përcakton vlerën e pronave që shpronësohen. Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan 12 veta. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

## VENDIM

**Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, parcela kadastrale Nr. 00494-15, arë e klasës së 4, në emër të Amer Shaqir Shurdhani, për zgjerimin dhe ndërtimin e rrugës “Ismail Raka” në Kaçanik / Lënda: 01Nr. 07-464/01-30640/20.**

**5.** Rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedhjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (40 vjet), parcelat kadastrale me numrat: 402-0 dhe 403-0, në ZK Kaçanik i Vjetër, P.SH KK Kaçanik;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Bekim Koxha**, Ne, edhe më herët jemi deklaruar së po jepen prona në shfrytëzim afatgjatë, pa interes të komunës. Nëse i epet në shfrytëzim një kompanie një pronë për 4 -5 vjet është diçka tjetër, ndërkaq me u dhënë në shfrytëzim afatgjatë prona e komunës për 40 vjet, është shumë dhe ne nuk do të përkrahim këtë rekomandim të komisionit vlerësues.

**z. Adnan Reka**, Ne jemi kundër të gjitha rekomandimeve që dalin nga ky Komision Vlerësues, për shkak se Komisioni ka qenë plotësisht ne sh përputhje me ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës; 1. Neni 17- Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, përbëhet prej pesë (5) anëtarëve. 2. Ka shkelur Rregulloren për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. Nenin 21 thotë: Kryesuesi I Komisionit Vlerësues brenda tre (3) dite pune pas mbylljes së njoftimit publik fton komisionin për hapjen dhe vlerësimin e ofertave. 3. Është shpërfillur konkursi publik i cili parasqeh dokumentacion e nevojshëm dhe kriteret për te aplikuar me oferta te mbyllura, dhe jo pas

hapjes se ofertave Komisioni t'i kërkoje ofertuesve çfarëdo dokumenti qe i mungon dhe te shpërfill krateret e kérkuara ne aplikacion, sepse kështu do te barazoheshin te gjithë ofertuesit, e pastaj do t'i jepet rekomandim Kuvendit jo ne baze te kritereve ligjore, por ne baze te preferencave politike. 4. Po te shihni procesverbalin e datës 20.09.2020, mund te vëreni qarte se edhe vete Komisioni ka pranuar se ka te beje me mungese te dokumentacionit te nevojshëm për të dhënë një rekomandim, dhe ishte pajtuar qe konkursi duhej te përsëritej pasi te jetë plotësuar me kritere shtese.

**znj. Vlora Dalloshi,** Unë jam kryesuese e komisionit të ankesave dhe iu njoftoj së për këtë rast nuk kemi pasur asnje ankesë. Për rastet që kemi pasur ankesa, i kemi vendosur si komision, ndërkaq për këtë rast nuk ka pasur ankesë dhe lënda është proceduar në Kuvendin e Komunës.

**z. Bekim Koxha,** Për pronat që janë dhënë më herët në shfrytëzim ka pasur ankesa, por pavarësisht ankesave, janë dhënë në shfrytëzim ato prona.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Anesa për pronat të cilat janë dhënë në shfrytëzim më herët, ka pasur, por jo nga ofertuesit, Ankesat kanë qenë private dhe ato çështje i kanë zgjidhur gjykatat.

**z. Besim Vishi,** A ka komuna ende prona të lira komunale për t'i dhënë në shfrytëzim ? Kjo më intereson përfaktin që, nëse na ofrohet ndonjë projekt për energji solare, a ka parcella të lira ku mund të realizohet ky projekt ?

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, Rekomandimin e komisionit vlerësues e shtroj në votim për aprovim; Për rekomandimin votuan 12 anëtarë, Kundër ishin 13 anëtarë, Abstenoj Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi së,

**Rekomandimi i komisionit vlerësues për përzgjedjen e ofertës ekonomikisht më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë (40 vjet), parcelat kadastrale me numrat: 402-0 dhe 403-0, në ZK Kaçanik i Vjetër, P.SH KK Kaçanik, kompanisë "KAÇINKA" L.L.C, NUK KALOJ / Lënda: 01Nr.104/02-30659/20.**

6. Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2021;

**Kryesuesi i Kuvendit,** E hapi diskutimin për këtë pikë; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë plan pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Aprovimin e Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2021 / Lënda: 01Nr. 060/01-29866/20.**

7. Raporti i punës i Shtabit Komunal për parandalimin e Covid -19;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**z. Bekim Koxha,** Raporti është i shkurtër, ndërkaq propozoj të miratojmë një kërkesë për subvencionimin e të gjitha rasteve të infektuara në komunën tonë.

**z. Ekrem Kyçyku,** Numri i të infektuarve është shumë më i madh sesa është i paraqitur në raport. Propozimi im është, me iu dalë në ndihmë familjeve në nevojë së paku me, rimbursim të barnave apo me pako ushqimore.

**z. Agim Mani,** Raporti është i përgjysmuar. Ne e dimë që menaxhimi i pandemisë në Kosovë ka dështuar, e edhe në komunën tonë, sepse menaxhimi i pandemisë nuk ka qenë i mirë. Rekomandimet e IKSHPK janë të mira, mirépo nuk janë respektuar të njëjtat, kur dihet se me të infektuarit kanë shkuan familjarët në QKMF, me blerë barna, sepse barna nuk ka pasur, nuk është mbajtur distanca e kështu me radhë.

Të dezinfektimi, shtabi ka rekomanduar me u bërë dezinfektimi i objekteve, mirépo asnje anëtar i shtabit nuk e dimë sesa m<sup>2</sup> e sipërfaqes së objekteve është dezinfektuar. Të statistikat, numri i të infektuarve është më i madh, sepse testi nuk po iu bëhet edhe familjarëve të infektuarit. Të zonat, duhet përmirësohet një gabim teknik, komuna jonë është në zonën e 10.

**Kryetari i Komunës, Besim Ilazi,** Përvendetje për të gjithë, fillimisht shfrytëzoj rastin t'iu uroj festat e fund vitit, iu dëshiroj suksese. Viti 2020 ishte vit sfidues, shpresoj 2021 të jetë vit i sukseseve të përbashkëta. Raporti është real me të dhënat të cilat i kemi deri me sot. Ju vet jeni anëtar i shtabit dhe mund t'i kërkoni këto të dhëna kur të doni edhe në shtab për çështjen e tenderit, kush e ka përfituar, sa ka qenë kontrata e m<sup>2</sup> e dezinfektuar, dhe sot mundesh me i marrë këto të dhëna tek organi përkatës. Të dhënat mund të merren edhe sot në shtab. Të dezinfektimi, janë dezinfektuar tre herë shkollat deri me tanë edhe gjatë vikendit, tanë është hera e katërt + asaj çdo javë punëtorët teknik e kanë obligim me tableta me një pompë me dezinfektuar varësisht nga nevojat dhe kërkesat. Çdo rekomandim i task forcës është marrë parasysh dhe e kemi miratuar në fundjavë.. Sa ka kushtuar nuk e di, por me duket si çështje e parasysh më me ngritë kur janë reale gjërat dhe dihen. Për numrin e të infektuarve, ne flasim me shifra zyrtare, meqë raporti kur është dhënë dallon me reportin zyrtar deri me datë 10. Raporti zyrtar është, 295 është numri i të infektuarve, 256 të shëruar, 28 janë aktiv, ndërkaq 11 raste me vdekje. Sa është i saktë ajo është diçka tjeter, ne thirremi në shifra zyrtare që na vijnë nga IKSHPK dhe këtë raport ua përcjellim organet kompetente. Pjesën e zbatimit të masave nuk e bënë as kryetari e as ekzekutivi, janë organet kompetente që merren me këtë punë dhe mundemi me dërguar një ankesë apo shqetësim tek organet përkatëse, policia, inspektori sanitari. Raporti është real, e jo i mangët, pjesa që na përket neve është kryer në formë shumë të mirë.

**z. Agim Mani,** Raporti si raport është i mangët, për faktin së nuk janë cekur rekomandimet e IKSHPK sa janë zbatuar. Pse mos me u cekur edhe rekomandimet e policisë sesa janë zbatuar, janë lëshuar 23 tiketa nga policia, pse mos me u cekur në raport ? Pse mos me u bashkangjitur këtij raporti edhe raporti financiar? Unë si anëtar i shtabit duhet t'i di këto dhe pse mos me i pasur këto të dhëna.

**Kryetari i Komunës,** Të dhënat janë në raporti e parë dhe të dytë. Ky është raporti i tretë që po e bëjmë. Rekomandimet i marrim nga instituti dhe apelojmë qytetarëve, ndërkaq zbatimin e masave e bënë dikush tjeter, për atë janë kategorizuar edhe qytetet, sa për njoftim ne si komunë jemi në zonën e gjelbër.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kur të bëhet raporti financiar për vitin 2020, aty ceken edhe mjetet e shpenzuara për menaxhimin e Covid-19. Raporti është sa për informim, kështu që konstatoj se Kuvendi i Komunës u,

### Njoftua

**Raporti i punës i Shtabit Komunal për parandalimin e Covid -19 (Raporti i tretë)**  
**/ Lënda: 01Nr. 104/02-29676.**

8. Raport i përbushjes së Planit të integritetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Lidhur me këtë pikë, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

**znj. Albana Lika (Troni)**, Ky raport i përket me tepër mënyrës dëshirore sesa realitetit. Po të shikojmë vetëm hyrjen e këtij rapporti, , na mjafton të kuptojmë sesa i pavërtetë është ky raport. Unë po i referohemi fjalisë ku thuhet” Angazhimi në këtë segment është kurorëzuar me suksese të njëpasnjëshme siç janë; raporti pozitiv i auditimit, përfitimi i grantit të përformancës etj. ju lutem, për çfarë raporti pozitiv të auditorit po flisni, ju kishit një raport skandaloze me shumë të gjetura. Po ashtu granti i përformancës së komunave për këtë vit, prej 5,200.000 eurosh, është anuluar nga MAPL, ambasada Suedaze dhe Ambasada Norvegjeze. Ky vendim tre palësh për anulimin e grantit për këtë vit, vjen si rezultat i mospajtimit të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës, i cili kishte konstatuar së kriteret e aplikuara në këtë raport ishin jo transparente dhe rezultati kishte anuluar grantin për këtë vit., ku komuna jonë e shtata në listë, por ky rezultat dhe i komunës tonë del të ishte i pasaktë kur ishte diskutuar raporti i përformancës , së ky raport mund të duket i mirë vetëm në letër , por në realitet është i pavërtetë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nuk është e vërtetë së është anuluar Granti i përformancës nga AKK, Ministri i MAPL e ka anuluar këtë grant, për faktin se komunat me shumicë serbe nuk dërgojë raport dhe nuk janë përfitues të këtij granti pa i plotësuar kriteret e vlerësimit që kërkohen.

**z. Adnan Reka**, Ne po i referohemi një dokumenti zyrtar të lëshuar nga ministri Rakiç për shkëputje të marrëveshjes për grantin e përformancës. A është marrë ndonjë grant për këtë vit ?

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nga kush e ke marrë atë vendim që po e potencon ?

**znj. Lirije Luta**, Po të ishim pjesë e trajnimit, kolegia, Albana nuk do të lexonte reagimin të cilin e bëri.

**z. Adnan Reka**, E drejta e secili është çka lexon, e jo qysh thoni ju znj. Lirije Luta.

**z. Ramadush Osmani**, Vlerësimi i përformancës është real, dikush ndoshta iu ka gjuar kësaj çështje dhe të gjithë e dimë që ministri i Pushtetit Lokal njëanshëm e ka shkëputur kontratën

**z. Adnan Reka**, Në Komunën e Kaçanikut Këshillat lokale në 33 vendbanime janë bërë pa procedurë të aklamacionit.

**z. Ekrem Kyçyku**, Raporti i përformancës ka pasur vërejtje, këtë e ka shfrytëzuar ministri i MPL, Rakiç për mos me përfituar grantin.

**z. Selim Reka**, Kur jemi të granti për përformancës, granti ka me u ekzekutuar tanë dhe mjetet ka me i marrë komuna.

**z. Ekrem Raka,** Me intereson të di, përse kaq vonë me na ardhur ky raport, kur dihet së jemi në fund të vitit 2020 ? A është procedura kështu apo çka është në pyetje? Më bëri përshtypje drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani që foli pak sa me nervozizëm. Është mirë me ruajtur gjuhën, sepse ne mundemi me marrë vendim që mos me pranuar raportimin nga drejtorët e drejtorive, së tek e fundit ju jeni të emëruarit e kryetarit e nuk jeni të zgjedhur.

**z. Ramadush Osmani,** Kërkoj falje nëse ju e merrni si nervozë diskutimin tim, por është e drejtë e imja me thënë së i keni marrë përgjigjet në pyetjet e parashtruara, sepse po thoni së nuk i kemi marrë, ndërkaq ju jeni dëshmitarë se i keni marrë përgjigjet.

**z. Bekim Koxha,** Kërkoj falje drejtorit të DSHPE, që e thashë së nuk i kam parë përgjigjet në kërkesat e ngritura, sepse kur i kam marrë materialet, nuk e kam parë së kanë qenë edhe përgjigjet apo janë dërguar më vonë.

**z. Festim Neziraj- drejtor i DAP,** Të nderuar anëtarë të Kuvendit, faleminderit për debatin që u ngritë për çështjen e përformancës, Transparency është vetëm një faktor e cila ndikon në ngritjen e integrititetit të përgjithshëm të komunës. Përveç ekzekutivit të komunës, këtu në disa pika përfshihen fusha të rrezikut dhe përgjegjësia që kemi si anëtar të KK ndaj institucionit. Andaj, kur është hartuar ky raport, jemi thirrur në të dhënrat të cilat janë në hyrje dhe material që janë paraparë në plan në fushat e rrezikut, dhe duke zbatuar këto fusha është nxjerrë raporti. Kjo që u tha me herët lidhur me raportin e auditorit, raporti është pozitiv, e dyta, jemi duke folur për raport të vitit 2019, ngjarja është e vitit 2020. Të dhënrat nuk janë të fryra, por janë në bazë të sinjalizuesit dhe të dhënave zyrtare, andaj besoj së është në rregull. Kërkoj falje që raporti ka ardhur me vonesë, për shkak të pandemisë dhe disa gjerave të tjera, besoj së për hera të tjera kjo nuk do të ndodhë.

**z. Ekrem Raka,** Harrova me përmendur se për kundër vërejtjeve, teksti në këtë raport është i shkruar mirë, pa gabime.

**z. Shemsedin Luzha,** Unë i kam dy të panjohura këtu: përformancë dhe Rakiç. Nuk mundet me pasur përformancë të mirë komuna, kur dihet së e kemi një pompë të benzinës të kundërligjshme. Që sa vjet nisur është halla e sporteve dhe nuk është përfunduar. Ka edhe çështje të tjera të cilat i shohim çdo ditë, ndërkaq në letër mundemi me i shkruar ndryshe.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Treguesit i bënë dikush tjetër e jo ne, ka shumë gjëra që janë mirë, por ka edhe që nuk janë mirë, mos të hyjmë në atë anë. Përforma është emër i përgjithshëm dhe dihet çka përfaqëson. Rakiç është emër i përvëcëm.

**z. Shemsedin Luzha,** Unë nuk desha me fyer askënd, problemi është i komunës, liria ime është deri sa të filloj e këtij tjetrit. Ne jetojmë në komunën e Kaçanikut, dhe i shohim krejt këto, kubëzat që janë vendosur në projektin e rrugës përreth xhamisë, shihet së nuk është punuar si duhet, kjo është tmerr së të zënë vetura në to, ndërkaq është investuar me mjetet e popullit të kësaj komune. Mua me mundon kjo punë, dhe unë dyshoj së ka përfitime të dikujt në këtë projekt.

**z. Adnan Reka,** Besoj së ju pajtoheni që opozita ka rol kritikues, mënyrën ne qysh kritikojmë po mendoni së ne po gjëzohemi. Ju arsyetonitë bazë të kritikave të cilat i bëjmë ne, pa u nervozuar. Për ne këto dokumente janë vetëm në letër, ndërkaq realiteti është ndryshe. Jemi komunë e varfér me shumë raste sociale, ndërkaq matësi i komunës tonë është më i mirë sesa i komunave tjera, si Ferizaj, Shtime të cilat kanë parametra më të mirë.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Vlerësimet janë nxjerrë në bazë të fushave që ka vlerësuar ministria. Unë nuk mendoj se askush nuk i gjëzohet vendimin për tërheqjen e grantit të përfomancës, kërkoj të fokusohemi në punë e t'i lëmë çështjet patriotike. Kontestimet nuk janë vetëm për komunën tonë, se kjo është për krejt Kosovën, është dokumenti. Nëse do ishte vetëm për Kaçanikun, atëherë është dashur me marrë me seriozisht këtë punë.

**z. Shemsedin Luzha,** Kur po përmendet patriotizmi, unë nuk e di së kush është duke shitur patriotizëm këtu. Ne kemi punuar për këtë vend, nuk bënë të injorojmë njëri tjetrin, edhe unë jam pjesë e atij kontributit për këtë çështje, nëse nuk e dinë, dhe mburrem me këtë. Unë pyeta për ata emrat që nuk po i njoh. Unë kam dëshirë me pa Kaçanikun qysh është më së miri, unë kam komuna tjera me afër, por unë jam i këtij vendi dhe punoj për të mirën e këtij vendi, paguaj taksa këtij vendi, ndërkaq çështja së ju e merrni ndryshe, ajo është diçka tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, kështu që konstatoj së Kuvendi i Komunës u,  
**Njoftua**

**Me Raportin e përbushjes së Planit të integritetit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2019 / Lënda: 01Nr. 02-104/02-30953/20.**

**9. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuara gjatë vitit 2020, shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Kaçanikut.**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Para se me hapur diskutimin për këtë pikë, jam i obliguar t'iu njoftoj së në vitin e kaluar kur kemi marrë një vendim të tillë, unë jam ftuar nga gjykata me u përgjigjur për nënshkrimin e atij vendimi, për shkak së është kontestuar nga Agjencioni Pyjor i Kosovës. Edhe pse në aspektin personal nuk ka pasur ndonjë arsy me më ftuar mua, por e kanë parë nënshkrimin tim, megjithëse unë jam i obliguar t'i nënshkruaj vendimet e KK, qoftë të ligjshme apo të paligjshme, pastaj është MAPL ajo që e shqyrton ligjshmërinë e vendimeve. Për atë vendim nuk kemi pasur konfirmim të ligjshmërisë nga MAPL. Unë kam shkuar në gjykatë dhe e kam arsyetuar dhe mendoj së është në rregull. Nuk do të thotë së edhe për këtë vendim nuk do të kemi padi nga APK sepse agjencionii kërkon që ne me i shitur drutë e konfiskuara përmes Ankandit, e pastaj 70% e tyre i shkojnë APK pasi që janë menaxhues të pyjeve. Nëse pyjet janë asete të komunës, komuna ka të drejtë me i shfrytëzuar asetet e veta sipas vendimeve që i marrim. Nëse pyjet janë asete të agjencionit, atëherë cila është përgjegjësia jonë? me i nxënë drutë me i paluar dhe me i ruajtur dhe në fund me ua dërguar ato mjete agjencionit. Tash nuk e di qysh është kjo çështje, cilido vendim që do të marrim, ne duhet të zbatojmë. Është çështje që ka të bëjë me institucionet tona, me iu dhënë me herët qysh morëm vendim familjeve në nevojë, e pamë që ishte edhe më gabim. Me ua ndarë shkollave të komunës drutë, ashtu si është propozuar me herët, nuk funksionoj, kështu që tani e shohim si do të vendoset kjo çështje.

**znj. Hafize Sallahu,** Përrshëndetje të për gjithë, Ne, edhe vitin e kaluar e kemi përkrahur Propozim Vendimin për ndarjen e druven të konfiskuara shkollave të komunës. Ajo që unë nuk jam e kënaqur është së, në çdo mbledhje të KK kemi shprehur shqetësimë për prerjen e druven në formë ilegale. Unë kam menduar së sivjet do të jetë sasi me e madhe e druven të konfiskuara, duke menduar së janë marrë masa lidhur me ankesat që janë ngritur në çdo mbledhje për prerësit ilegal të pyjeve. Unë si subjekt politik nga NISMA e përkrahi këtë Propozim Vendim për me ua ndarë drutë shkollave, por nuk jam e kënaqur, përfaktin së nuk janë marrë masa për

ndalimin e prerëseve ilegal të pyjeve të komunës. Nuk kam shifër të saktë me krasuar sasinë e druve të konfiskuara të vitit të kaluar me këto të këtij viti, por nga sasia e vogël e druve të konfiskuara, po na bënë me kuptuar së nuk janë marrë masa.

**z. Ekrem Kyçku,** Sasia prej 116.19 m<sup>3</sup> e druve të konfiskuara, konsideroj së është shumë e vogël. Unë si bjeshkatar që jam, nuk ka kodër që nuk e kam vizituar, gjendja në teren është alarmante, kam edhe fotografi të realizuara për këtë çështje. Po e llogarisim malet e Sharrit që janë përgjegjësi e Parkut kombëtar, mirëpo gjendja nuk është më e mirë edhe në pjesët tjera në pjesën lindore të komunës tonë, sepse nuk ka dru më të trashë së 10 cm që nuk janë prerë. Ju ftoj të dalim së bashku në ditën e diel në terren dhe kemi me parë 5-6 sharra dëgjohen duke prerë dru, prehen edhe drutë nga 5 cm, ndërsa nuk del kush me i parë çka po ndodhë. Kjo është një anarki që po ndodhë në pyjet e komunës tonë, me çka kemi dështuar %% në mbrojtjen e pyjeve.

**z. Bekim Koxha,** Më të vërtetë me folur për pyjet, nuk e di çka ka me keq, kjo është krimi më i madh që është duke bërë. Nuk e di a kemi diçka me keq sesa çështja e shkatërrimit të pyjeve që është duke u bërë. Çfarë drejtorësh, çfarë punëdhënës ka, jemi komunë, kemi pushtet, ndërkaq kanë marrë kurrfarë masash me i mbrojtur pyjet. Unë mendoj së dështimi më i madh është në mbrojtjen e pyjeve, mbrojtje të ambientit si të lumenjtë ashtu edhe të pyjet. Me vjen keq që drejtori është këtu prezantë këtu, por kurrfarë masash nuk ka ndërmarrë me i mbrojtur pyjet.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kur është fjala të sasia e pyjeve të konfiskuara, keni të drejtë të thoni së është sasia e vogël në krasim me shkatërrimin e pyjeve. Një pjesë e përgjegjësisë nuk është e jona, si çështja e parkut nacional, ndërkaq edhe pjesa tjetër që është përgjegjësi tona është pak me mirë, por jo edhe shumë mirë. Të fokusohemi më tepër të ndarja e masës drusore. A ka diskutime tjera.

**z. Selim Reka,** Unë jam me përkrahur Propozim Vendimin që drutë e konfiskuara t'i ndahen shkollave të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozim Vendimin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Për ndarjen e masës drusore të konfiskuara gjatë vitit 2020, pjesa që i takojnë komunës, t'i ndahet shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Kaçanikut/ 01 Nr. 104/02-31030/20.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ju njoftoj së sipas vendimeve të ministrisë nuk kemi pasur organizime në fund vit. Ne zakonisht e kemi pasur një drekë pune në fund vit, mirëpo kjo nuk do të realizohet. Me këtë mbledhje i përfundojmë aktivitetet e Kuvendit të Komunës të vitit 2020, urime festat e fund vitit, shihemi në vitin 2021.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:35. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KK.

Procesmbajtës:  
Makfire Malsiu

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS  
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);**

**nga Mbledhja e XI –të (Njëmbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2020, mbajtur me 24 Dhjetor 2020;**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma .....,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Dema.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku .....,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Kodra......
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Lika..... .....
23. Rabije Sallahi,.....,
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi .....,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....